

Ky Dokument me Informacionet Kyçe për Investitorët (DIKI) i ofron lexuesit informacionet kyçe për portofolin investues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës. Ky nuk është material marketingu; ofrohet që t'i ndihmoj lexuesit për ta kuptuar natyrën dhe risqet e portofolit.

## FKPK – Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (EUR)

fond me kontribute të definuara i kursimeve pensionale i themeluar me ligj dhe i menaxhuar nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës.

### Objektivat dhe Politika e Investimeve

#### Objektivat

FKPK-ja investon mjetet me këndvështrim afatgjatë dhe me qëllim kryesor që të sigurojë investime të matura dhe në përputhje me kërkesat e Ligjit.

Qëllimet e investimit të matur të portofolit janë:

- Siguria e mjeteve pensionale;
- Diversiteti i investimeve;
- Kthimi maksimal në përputhje me sigurinë e mjeteve pensionale; dhe
- Mirëmbajtja e likuiditetit adekuat.

Para vitit 2013 portofoli nuk kishte referencë (bençmark). Më pas, Indeksi i Çmimeve të Konsumit në Kosovë (IÇK) u përvetësua si referencë kundrejt së cilës do të matet performanca e portofolit. Kjo referencë gjykohet të ofrojë cak të qartë dhe të matshëm për synimin, që në afat të gjatë, të ruhet kapitali edhe në terma nominalë edhe realë.

#### Politika investuese

Mjetet investohen në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-101 mbi Fondet pensionale në Kosovë (dhe amendamentet pasuese të tij), dhe vetëm me qëllim përfitimet për pjesëmarrësit. Bordi Drejtues është përgjegjës për caktimin e politikës investuese si dhe caqeve për alokim të mjeteve. Politika investuese është e shprehur si një miks caqesh që ndahen sipas:

- klasave të asetëve: kesh, instrumente borxhi, aksione, ose multi-asete; dhe
- strategjive investuese: ofrim interesi, drejtimore me tregun, ose kthim absolut / menaxhim risku / targetim risku.

Mjetet pensionale investohen në miks instrumentesh financiare si depozitat bankare, fletobligacionet e Thesarit të Kosovës dhe kryesisht në fondet e hapura (*mutual*).

Fondet në përputhje me strategjinë investuese dhe të alokimit të mjeteve në fuqi përzgjedhen si një mënyrë efikase dhe e diversifikuar për t'u qasur tek klasat e asetëve dhe strategjitë investuese të dëshiruara.

Për menaxhim të risqeve direkte, janë vendosur caqe në kuadër të kornizës investuese që kufizojnë alokimin në:

- një klasë asetesh:
  - 50% - Kesh dhe fonde të parash së gatshme;
  - 40% - Fletobligacione të Kosovës & fonde obligacionesh;
  - 55% - Instrumente të aksioneve; dhe
  - 55% - Multi-asete, dhe
- Strategjitë e përzgjedhura investuese:
  - 70% - Gjenerim interesash;
  - 60% - Kthim drejtimor / instrumente pa menaxhim risku; dhe
  - 68% - Kthim absolut / menaxhim risku / targetim risku.

Fondi përbëhet nga vetëm një portofol për të gjithë pjesëmarrësit. Si rrjedhojë, alokimet i balancojnë interesat e personave që do të pensionohen në të ardhmen e afërt me interesat e atyre që kanë kohë më të gjatë para pensionimit. Politika investuese synon t'i zbusë efektet negative të tregjeve në rënie e duke marrë pjesë në fitime kur tregjet ngriten. Kjo qasje e qëndrueshme synon të akumulojë kthime të balancuara për të gjitha grupmoshat.

### Profili i Riskut dhe Shpërblimit

#### Risk më i ulët

Shpërblim potencialisht më i ulët

#### Risk më i lartë

Shpërblim potencialisht më i lartë



#### Indikatori i riskut dhe shpërblimit

Kategoria e riskut të portofolit bazohet në luhatshmërinë e performancave javore përgjatë pesë vjetëve të fundit; por, kjo mund të ndryshojë me kohë meqë performanca historike mund të mos jetë indikator i besueshëm për të ardhmen.

Portofoli ndodhet në këtë kategori sepse ndërmer risk të moderuar në kërkim të kthimeve stabile dhe çmimi i tij mund të rritet ose të bie varësisht nga rrethanat.

Një portofol në kategorinë më të ulët nuk nënkupton investim pa risk.

#### Faktorët e riskut

Në vijim janë paraqitur disa nga risqet kryesore që mund të ndikojnë në performancën e portofolit:

**Risku i tregut:** Risku i rënies për shkak të faktorëve që ndikojnë në performancën e përgjithshme të tregjeve financiare ndaj të cilave është ekspozuar portofoli.

**Risku i çmimit:** Risku i rënies në vlerë të një instrumenti apo fondi, që mund të minimizohet përmes diversifikimit.

**Risku i inflacionit:** Risku që inflacioni të gërryjë dhe ulë fuqinë blerëse të mjeteve.

**Risku i palës tjetër:** Risku që pala tjetër, pjesërisht ose tërësisht, të mos jetë në gjendje t'i shlyejë detyrimet e saj ndaj portofolit.

**Risku i likuiditetit:** Risku që obligimet afatshkurtra financiare të mos mund të përmbushen.

**Risku i vlerësimit:** Risku që një aset është i mbivlerësuar dhe vlen më pak sesa që pritej kur matoron apo shitet.

## Tarifat

Tarifat e FKPK-së ngarkohen në baza ditore mbi mjetet bruto të portofolit. Çdo vit FKPK-ja i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës nivelin e tarifave për t'u ngarkuar.

Niveli i tarifave në fuqi për vitin 2020, siç janë miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ishin:


- (a) Tarifa vjetore operacionale: 0.065%; dhe
- (b) Tarifa vjetore investuese: 0.330%.

FKPK-ja nuk ngarkon tarifa të hyrjes, daljes, apo çfarëdo tarife tjetër përveç atyre të përmendura më lartë.

Tarifat e ulin vlerën e mjeteve të pjesëmarrësve; megjithatë, si institucion jo-për-fitim, tarifat e ngarkuara nga FKPK-ja i mbulojnë vetëm shpenzimet e saja:

- (a) Tarifa operacionale: shpenzimet e personelit dhe shpenzimet e tjera zyrtare e administrative; dhe
- (b) Tarifa investuese: shpenzimet për ndërmjetësim, kujdestari, transfere, tarifa të fondeve të hapura, dhe shpenzimet e tjera që ndërlidhen direkt me investimin e mjeteve në tregjet globale financiare në kërkim të kthimeve pozitive për pjesëmarrësit.

## Performanca historike



Performanca historike mund të mos jetë indikator i besueshëm për performancën në të ardhmen. Vlera e investimeve mund të ngritet por edhe të bie.

Performanca është përlogaritur si përqindja e ndryshimit të çmimit të njësisë gjatë secilit vit. Ajo është llogaritur pas tarifave dhe në valutën EUR.

Luhatshmëria është përlogaritur si devijimi standard i vjetorizuar i performancave ditore të portofolit për vitin e caktuar.

Portofoli është lansuar më 1 gusht 2002.

## Informata praktike

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) është krijuar me Ligj nga Kuvendi i Republikës së Kosovës si institucioni i vetëm i autorizuar për administrimin e – dhe menaxhimin e – investimeve të – Mjeteve Pensionale, pra, kontributeve të obligueshme (dhe vullnetare) të kursimeve pensionale të punonjësve në Kosovë.

FKPK është regjistruar pranë Ministrisë së Administratës Publike me Numër Regjistrimi 9000225 - në Rr. "Agim Ramadani" 182-184, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës – dhe mbikëqyret nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

Aktualisht fondi përbëhet nga një portofol i vetëm për të gjithë pjesëmarrësit, duke balancuar nevojat e pjesëmarrësve që janë afër pensionimit dhe atyre që kanë shumë vite të kursimit përpara se të pensionohen. Ekziston dispozita ligjore sipas së cilës fondi mund të ndahet në disa portofole të veçanta sipas moshës, me qëllim që grupmoshave të ndryshme të pjesëmarrësve t'iu sigurohet një profil përkatës i riskut varësisht afërsisë ndaj moshës së pensionimit. Kjo do të kërkonte vendim nga Bordi Drejtues i FKPK-së.

Më shumë informata në lidhje me Parimet e Investimeve dhe menaxhimin e riskut mund të gjenden në Manualin e Investimeve të FKPK-së në: [www.trusti.org/sq/investimet/manuali-i-investimeve/](http://www.trusti.org/sq/investimet/manuali-i-investimeve/).

Më shumë informata mbi fondet e hapura të shfrytëzuara nga FKPK-ja – duke përfshirë performancat përkatëse, qëllimet, tolerancën e riskut, plasmanet individuale dhe institucionin depozitues – mund të gjenden në: [www.trusti.org/sq/investimet /fondet-e-hapura-investuese/](http://www.trusti.org/sq/investimet/fondet-e-hapura-investuese/).

Çmimet historike të njësisë dhe ato më të fundit janë të publikuara në: [www.trusti.org/sq/investimet/cmimi-i-njesise/](http://www.trusti.org/sq/investimet/cmimi-i-njesise/).

Ky DIKI është përditësuar dhe publikohet me informacionin në posedim deri në dhjetor 2020.